

University of Business and Technology in Kosovo

**UBT Knowledge Center**

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Fall 11-2011

## **Institucionet financiare dhe ndikimi në ekonominë globale**

Samire Kurtishi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**

---



Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**Institucionet financiare dhe ndikimi në ekonominë globale**

Shkalla Bachelor

Samire Kurtishi

Nëntor/2011  
Prishtinë



Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti Akademik 2007 - 2008

Studentja: Samire Kurtishi

**Institucionet financiare dhe ndikimi në ekonominë globale**

Mentori: Arton Celina

Nëntor/2011

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të  
pjeshme për Shkallën Bachelor

## PËRMBAJTJA

SHKURTESAT.....	6
ABSTRAKTI.....	7
1. HYRJA.....	8
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	9
<b>2.1. Funksonet e institucioneve financiare.....</b>	<b>10</b>
<b>2.2. Vlerësimi i institucioneve financiare.....</b>	<b>11</b>
3. INSTITUCIONET FINANCIARE DEPOZITUESE.....	12
<b>3.1. Bankat komerciale.....</b>	<b>13</b>
<b>3.2. Asociacionet e kursimeve dhe të kreditit.....</b>	<b>13</b>
<b>3.2.1. Bankat e kursimeve.....</b>	<b>13</b>
<b>3.2.2. Unionet e kreditit.....</b>	<b>14</b>
4. INSTITUCIONET FINANCIARE JODEPOZITUESE.....	14
<b>4.1. Institucionet financiare kontraktuese.....</b>	<b>14</b>
<b>4.2. Institucionet investuese.....</b>	<b>15</b>
5. INSTITUCIONET BANKARE.....	15
<b>5.1. Banka Qendrore.....</b>	<b>16</b>
<b>5.2. Banka Qendrore e Kosovës.....</b>	<b>18</b>
<b>5.2.1. Funksonet dhe përgjegjësit e Bankës Qendrore të Kosovës.....</b>	<b>18</b>
<b>5.2.2. Paraja në qarkullim.....</b>	<b>20</b>
<b>5.2.3. Funkzioni statistikor i BQK-së.....</b>	<b>21</b>
<b>5.2.4. Sistemi Bankar në Kosovë.....</b>	<b>21</b>
6. INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE.....	25
<b>6.1. Organizatat financiare depozituese.....</b>	<b>25</b>
<b>6.2. Institucionet për kursin e kontraktuar.....</b>	<b>25</b>

6.3. Organizatat financiare investive.....	26
6.4. Kompanit financiare.....	26
6.5. Organizatat financiare të përziera.....	26
7. INSTITUCIONET QENDRORE TË QARKULLIMIT TË PAGESAVE.....	27
7.1. Gjiro institucionet qendrore dhe bankat e kursimeve.....	27
8. ORGANIZATAT FINANCIARE NDËRKOMBËTARE.....	28
8.1. Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) ose (FMN).....	29
8.2. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).....	30
8.2.1. Kapitali deponues ose pagues.....	32
8.2.2. Kapitali garantues.....	32
8.2.3. Mjetet e mbledhura në tregun e kapitalit.....	32
8.2.4. Mjetet nga të hyrat e realizuara.....	33
8.2.5. Mjetet nga kryegjëja e huave të dhëna më parë.....	33
8.3. Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC).....	34
8.4. Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA).....	35
9. ORGANIZATAT FINANCIARE REGJIONALE.....	36
9.1. Banka për Likuidimin e Llogarive Ndërkombëtare.....	36
9.2. Banka Ndërkombëtare për Bashkëpunimin Ekonomik (KNER).....	37
9.3. Unioni Evropian i Pagesave.....	37
9.4. Banka Investive Evropiane (EIB).....	37
9.5. Banka Ndërkombëtare Investive (IIB).....	38
9.6. Banka Interamerikane për Zhvillim.....	38
9.7. Banka Aziatike për Zhvillim (ADB).....	39
9.8. Banka Afrikane për Zhvillim (ADB).....	39

<b>9.9. Banka Islamike për Zhvillim (IDB).....</b>	<b>40</b>
<b>9.10. Banka Arabe për Zhvillim Ekonomik (ABED).....</b>	<b>40</b>
<b>10. PËRMBAJTJA E SIGURIMEVE INSTITUCIONALE.....</b>	<b>41</b>
<b>10.1. Shoqërit e sigurimit të jetës dhe pasurisë.....</b>	<b>42</b>
<b>10.2. Fondet e pensionëve.....</b>	<b>43</b>
<b>11.KONKLuzionET.....</b>	<b>44</b>
<b>11. PËRFUNDIMI.....</b>	<b>46</b>
<b>12. REFERENCAT/LITERATURA.....</b>	<b>49</b>

## SHKURTESAT:

(FMN) ose (IMF) – Fondi Monetar Ndërkombëtar.

(IBRD) – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

(IFC) – Korporata Financiare Ndërkombëtare.

(IDA) – Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim.

(KNER) – Banka Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ekonomik.

(EIB) – Banka Investive Evropiane.

(IIB) – Banka Ndërkombëtare Investive.

(ADB) – Banka Aziatike për Zhvillim.

(ADB) – Banka Afrikane për Zhvillim.

(IDA) – Banka Islamike për Zhvillim

(ABED) – Banka Arabe për Zhvillim Ekonomik.

## ABSTRAKTI

Duke e ditur se institucionet financiare kanë ndikim shumë të rëndësishëm në ekonominë e një vendi ne kemi vendosur që të marrim për temë të diplomës dhe ta shqyrtojmë më shumë në mënyrë që të kuptojmë rreth kësaj teme si dhe të sqarojmë kuptimin e tyre.

Ne gjatë studimit të temës Institucionet financiare dhe ndikimi në ekonomi kemi mësuar për funksionet e tyre kryesore, llojet e institucioneve financiare dhe ndikimin e bankës qendrore që ka në to.

Gjatë shqyrtimit të kësaj teme ne kemi mësuar edhe për institucionet financiare jobankare, Organizatat financiare ndërkombëtare, Organizatat financiare Regjionale etj.

Në këtë temë kemi mësuar edhe për sistemin bankar në Kosovë, bankat komerciale të cilat zhvillojnë veprimtarin e tyre mjaft profitabile në Kosovë, bankat me kapital vendor dhe të huaj.

Bankat në Kosovë edhe pse kanë kamatat mjaft të larta dhe pretendojnë që kanë rrezik të madh në Kosovë ato për nëntë mujorin e parë të 2011 kanë fituar një profit të paster prej 25 milion Euro.

Fitimi i bankave në 9- mujor është për rreth 11 milionë euro më i lartë për tre muajt e fundit, nga gjysma e parë e këtij viti, pasi që deri në qershor ato kishin fituar 14.9 milionë euro.

Fitimet më të larta për periudhën janar-shtator 2011 i ka shënuar Pro Credit Bank prej 10.1 milionë euro, e pasuar nga Raiffeisen Bank me 7.6 milionë euro, NLB Prishtina 3.3 milionë euro, TEB 1.7 milion euro, Banka Ekonomike 1.1 milion euro, Banka për Biznes 523 mijë euro, 119 mijë euro Banka Kombëtare Tregtare dhe 23 mijë euro i ka fituar dega në Kosovë e Komercialna Bankës të Serbisë, e cila operon kryesisht në vendbanimet serbe në Kosovë.( /Zëri/Telegrafi)



## 1.HYRJE

Duke e ditur se institucionet financiare janë një lëmi e gjerë në ndikimin e ekonomisë së zhvilluar po ashtu janë organizata që përfshihen në dhënien e llojeve të ndryshme të shërbimeve financiare, do të përpiqemi që në këtë punim të veçojmë disa çështje të cilat mendojmë se janë më të rëndësishme për stabilizimin e zhvillimit të ekonomisë në mbledhjen e fondeve nga investitorë të drejtëpërdrejtë për ofruesit e shërbimeve të ndryshme financiare.

Ne gjatë studimit të temës Institucionet financiare dhe ndikimi në ekonomi, kemi mësuar se institucionet financiare në transferimin e parave ose fondeve për nivelet e ndryshme të ekonomisë, luajnë një rolë të rëndësishëm dhe vepronë në bazë të skenerit të mbrendshëm ekonomik ndërkombëtarë.

Me punimin e kësaj teme ne kemi mësuar se bankat janë institucione financiare shumë të rëndësishme që kanë ngjajshmëri me organizatat tjera ekonomike, pasi që bankat janë burimi kryesor i kredive për individët, familjet, si dhe institucionet dhe ndërmarrjet e ndryshme. Po ashtu bankat janë institucionet financiare të sistemit monetar ku janë të detyruara të kujdesen për vlerën e njësisë monetare të një vendi, për rregullimin e qarkullimit të parave dhe të likuiditetit të sistemit bankar si dhe për likuiditetin në vend dhe atë ndërkombëtarë.

## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Institucionet financiare janë ato organizata, që përfshihen në dhënien e llojeve të ndryshme të shërbimeve financiare të klientëve të tyre. Institucionet financiare janë të kontrolluara dhe të mbikqyrura nga rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga autoritetet qeveritare.

Disa nga institucionet financiare që funksionojnë si ndërmjetësues në tregjet e aksioneve dhe tregjet e sigurisë së borxhit. Funksioni kryesorë të institucionet financiare është mbledhja e fondeve nga investitorët të drejtëpërdrejtë të fondeve për ofruesit e shërbimeve të ndryshme financiare.

Institucionet financiare merren me aktivitete të ndryshme financiare që lidhen me obligacione, letrat e borxhit, aksione, kreditë, diversifikimin e rrezikut të sigurimit, planifikimin e daljes në pension, investimet, menaxhimin e portofolit dhe shumë lloje të tjera të lidhura me funksionet. Me ndikimin e funksioneve të tyre, institucionet financiare të transferimit të parave ose fondeve për nivelet e ndryshme të ekonomisë në këtë mënyrë luajnë një rol të rëndësishëm dhe vepron në bazë të skenarit të mbrendëshëm ekonomik ndërkombëtar.

Për kryerjen e operacioneve të biznesit të tyre, institucionet financiare zbatojnë lloje të ndryshme të modeleve ekonomike, ku po ashtu ndihmojnë klientet e tyre dhe investitorët për të maksimizuar fitimet e tyre duke i bërë udhëzimet e duhura. Institucionet japin një gamë të gjerë të programeve edukative për edukimin e investitorëve mbi bazat e investimit dhe gjithashtu në lidhje me vlersimin e aksioneve obligacioneve, asetëve, mallrave dhe shkëmbimet e huaja.<sup>1</sup>

Në përgjithësi ka tri lloje kryesore të institucioneve financiare:

- a) Institucionet që pranojnë dhe menaxhojnë depozita dhe japin kredi, përfshirë këtu edhe bankat, shoqëritë ndërtimore, unionet e kreditit, kompanitë e besimit dhe kompanitë e huaja hipotekare.

---

<sup>1</sup> <http://finance.mapsofWorld.com/financial-institutions/>

- b) Kompanit e sigurimeve dhe fondet e pensioneve.
- c) Ndërmjetësuesit në bazë të fondeve monetare.<sup>2</sup>

## **2.1. Funkcionet e institucioneve financiare**

Në funksionet e institucioneve financiare bëjnë pjesë bankat, unionet e kreditit, firmat e menaxhimit të aseteve, ndërtimin e shoqërive dhe ndërmjetësit e aksioneve. Këto funksione janë përgjegjëse për shpërndarjen e mjeteve financiare në mënyrë të planifikuar për përdoruesit e mundshëm. Ka një numër të madhë të institucioneve, që mbledhin dhe sigurojnë fonde për sektorin e nevojave individuale. Nga ana tjetër ka disa institucione të cilat veprojnë si ndërmjetës për ti bashkuar njësit e deficitit të tepërta, ku investojnë të holla në emër të klientit e që është një funksion ndryshe në institucionet financiare.

Në funksionet e institucioneve financiare qëndrojnë edhe bursat, tregjet e mallrave, monedhat dhe mundësit e shkëmbimeve ku janë shumë të rëndësishme për ekonomin. Këto institucione janë të përfshira në krijimin dhe sigurimin e pronësisë për pretendime financiare, gjithashtu janë edhe përgjegjëse për ruajtjen e likuiditetit në treg dhe menaxhimin e rreziqeve të ndryshimit të çmimeve. Si pjesë e shërbimeve të tyre sigurojnë mundësitë e investimeve për ti ndihmuar bizneseve për gjenerimin e fondeve për qëllime të ndryshme.

Në funksionet e institucioneve financiare bankat e investimit janë gjithashtu jetike dhe të lidhura me sektorin e investimeve. Këto kompani janë të përfshira në një numër të veprimtarive financiare, të tilla si letra me vlerë, shitjen e letrave me vlerë për investitorët duke siguruar shërbime brokerimi dhe ngritje të fondeve.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> [http://en.Wikipedia.org/Wiki/Financial\\_institution](http://en.Wikipedia.org/Wiki/Financial_institution)

<sup>3</sup> <http://finance.mapsofWorld.com/financial-institutions/functions.html>

## **2.2.Vlerësimi i institucioneve financiare**

Vlerësimi i institucioneve financiare ka të bëjë me vlerësimin e fletëve të bilancit dhe shumë aspektëve të institucioneve financiare. Një numër i madhe i firmave të vlerësimin të korporatave janë duke operuar në tregun financiar, ku ofrojnë shërbime me vlerë të institucioneve financiare në lidhje me vlerësimin e tyre. Vlerësimi i tregut të një institucioni financiar është i varur nga faktorët e ndryshëm e që janë:

- a) Strategjia korporative dhe pozicionimi konkurrues.
- b) Kryerja e operacioneve.
- c) Rritja e të ardhurave.
- d) Menaxhimin e kapitalit.
- e) Përceptimin e tregut.
- f) Zbatimin e tregut.

Procesi i vlerësimin të institucioneve financiare është i njohur si vlerësim i korporatave ose si vlerësim i institucioneve financiare.

Vlerësimi i institucioneve financiare mbanë një shkallë të konsiderueshme me rëndesi në tregun financiar për shkakë të një arsyeje të thjeshtë të kompanive që kanë vlera të larta të aseteve dhe fitimit neto që tërheqë numër të madh të investitorëve. Menaxhimi i vlerës së institucioneve financiare mundëson, këto institucione financiare për të prodhuar vlera të mëdha për aksionerët me ndihmën e rrezikut të përshtatshëm dhe të menaxhimit të financave.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> <http://finance.mapsofWorld.com/financial-institutions/valuing.html>.

### 3. INSTITUCIONET FINANCIARE DEPOZITUESE

Në ekonominë e tregut, aktivitetin e biznesit e harton ndërmarrjet financiare dhe jofinanciare. Ndërmarrjet jofinanciare prodhojnë produkte ( p.sh. shërbime transporti, shërbime komunale, programe kompjuterësh, etj ). Ndërmarrjet financiare ndryshe janë të njohura si institucione financiare.

Ndërmarrjet financiare përfshijnë institucionet depozituese - bankat komerciale, shoqatat e sigurimeve, të huave, bankat e kursimeve dhe unionet e kredisë, të cilat sigurojnë shuma të mëdha të fondeve të tyre përmes pranimi të depozitave nga publiku dhe përmes angazhimit të kësaj paraje të grumbulluar në huadhënie për kompanitë e sigurimeve, fondet e penzioneve dhe kompanitë e tjera financiare. Dallojnë institucionet financiare depozituese dhe jodepozituese.

Institucionet depozituese përfshijnë bankat komerciale ose thënë shkurt bankat, asociacionet e kursimeve dhe të huave, bankat e kursimeve dhe unionet e kreditit, ku janë ndërmjetës financiar të cilët pranojnë depozita – pranuese. Me fondet e shtuara përmes depozitave dhe fondet tjera nga burime të ndryshme, institucionet depozituese po ashtu u japin hua direkte entiteteve të ndryshme dhe investojnë në letra me vlerë.<sup>5</sup>

Të ardhurat e tyre derivojnë nga tri burime:

- a) Të ardhurat e gjeneruar nga huatë e dhëna .
- b) Letrat e blera me vlerë.
- c) Nga tarifatat e shërbimit.

---

<sup>5</sup> Dr. Safet Merovci: “Tregjet dhe instrumentet financiare”, Prishtinë, 2004, faqe 256.

### **3.1. Bankat komerciale**

Bankat komerciale paraqesin grupin më të madhë të institucioneve financiare depozituese. Vetëm në SHBA janë rreth 13.500 banka komerciale, të licencuara në nivel të shtetit ose në nivel federal.<sup>6</sup>

Këto banka lejojnë të gjitha llojet e kerdisë, kryejnë punët në lidhje me letrat me vlerë, u japin informata organizatave monopoliste ndërkombëtare etj.

Bankat komerciale disponojnë shuma të mëdha mjeteve financiare, rrjet të zhvilluar të filialeve dhe teknologji më bashkohore, ato u konkurojnë dukshëm bankave të tjera kombëtare të atij teritori, në të cilin e ushtrojnë veprimtarin e tyre.<sup>7</sup>

### **3.2. Asociacionet e kursimeve dhe të kreditit**

Asociacionet e kursimeve dhe të kreditit janë institucione financiare mjaft të vjetra. Ato ishin të përhapura veçmas në vitet '60 dhe '70, sepse trendet e atëhershme ishin të orientuara në gjetjen e mënyrave të sigurimit të fondeve për financimin e furnizimeve shtëpiake – produkteve të qëndrueshme dhe të financimit të blerjeve të pasurive të pa tundshme – shtëpive dhe apartamenteve, sipas parimeve të kredive hipotekare.<sup>8</sup>

#### **3.2.1. Bankat e kursimeve**

Bankat e kursimeve janë institucione gati të njëjta me asociacionet e kursimeve dhe të kreditit. Megjithatë, kursimoret (bankat e kursimeve) janë më të vjetra, më të mëdha, respektivisht ato disponojnë me kapitale më të mëdha por me numër janë më pakë se sa asociacionet e kursimeve dhe të kreditit.

Në portofolien e bankave të kursimeve janë të përfshira obligacionet e ndërmarrjeve, letrat me vlerë të organeve lokale qeverisëse, aksionet e zakonshme dhe huatë e konsumatorëve. Burimi themelorë i mjeteve të kursimorëve janë depozitët.

---

<sup>6</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: "Financat", Prishtinë, 2008, faqe 174.

<sup>7</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 23.

<sup>8</sup> Dr. Safet Merovci: "Tregjet dhe instrumentet financiare", Prishtinë, 2004, faqe 260.

### **3.2.2. Unionet e kreditit**

Unionet e kreditit janë institucionet më të vogla dhe më të reja depozituese. Aspekti i tyre unik është “detyrimi i përbashkët” që kërkohet për anëtarët e unionit të kreditit. Unionet organizohen ose si korporativa ose në pronësi të përbashkët, këtu nuk kemi pronësi aksionare. Qëllimi i unioneve të kreditit është që të ofrojnë shërbime për nevojat e anëtarëve të saj për kursime dhe për hua.

Unionet e kreditit fondet e tyre i sigurojnë kryesisht nga depozitët e anëtarëve të saj. Asetet e unioneve të kreditit përbëhen kryesisht nga huatë e vogla për konsumatorët, për anëtarët e saj. Ato sigurojnë shërbime kreditimi në bazë të kartave të kreditit.<sup>9</sup>

## **4. INSTITUCIONET FINANCIARE JODEPOZITUESE**

Karakteristikat kryesore institucioneve financiare jodepozituese është se deri te mjetet e tyre që u mundësojnë kryerjen e aktiviteteve biznesore, nuk vinë përmes mbledhjes së depozitave nga publiku dhe institucionet tjera financiare dhe jofinanciare për këtë e bëjnë nga komisionet dhe nga investimet e tyre.

Dallojmë dy grupe të institucioneve financiare jodepozituese:

- a) Institucionet kontraktuese.
- b) Institucionet investuese.

### **4.1. Institucionet financiare kontraktuese**

Këto institucione përfshijnë kompanitë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve. Këto institucione me pasivin e tyre e kanë komoditetin që të investojnë në instramente financiare afatëmesme dhe afatgjata, sepse nga ato kërkohet një shkallë më e ulët e likuiditetit, që buron nga struktura e pasivit të kapitalit të tyre. Institucionet jofinanciare nuk janë çdoherë të sigurta se sa do t'i kenë shumat në disponim si dhe kohën respektivisht momentin kur duhet te kryhen obligimet e kontraktuara.

---

<sup>9</sup> Dr. Safet Merovci: “Tregjet dhe instrumentet financiare”, Prishtinë, 2004, faqe 262.

## 4.2. Institucionet investuese

Këto institucione investuese përfshijnë një mori kompanish dhe fondesh investuese të cilat tashmë kanë kaluar në lloje të pastër të kompanive ndërmejtësuese, sepse deri tek mjetet e tyre arrijnë me emetimin e letrave me vlerë (aksioneve), ndërsa i plasojnë në portofole të diversifikuara të letrave të tjera me vlerë në segmente të ndryshme të tregjeve financiare.<sup>10</sup>

## 5. INSTITUCIONET BANKARE

Baka është një institucion shumë i rëndësishëm që ka ngjashmëri me organizata tjera ekonomike (pra ka një status të pavarur juridik, punonë sipas parimit të ekonomizimit dhe rentabilitetit, etj), mirëpo njëkohësishtë ka edhe specifikat e veta që i dallon nga grupi i organizatave ekonomike dhe radhitet në grupin e institucioneve të veçanta të një ekonomie. Bankat janë një nga institucionet më të rëndësishme të një ekonomie, pasi që ato janë burimi kryesor i kredive për individët, familjet, si dhe institucionet dhe ndërmarrjet e ndryshme.<sup>11</sup>

Gjurmët e para të bankave i gjejmë kah viti 3000 para e.r. në Azinë Qendrore. Një ndër zbulimet kanë qenë pllakatë e Argjilit të cilat janë gjetur në “Tempullin e kuq” që paraqesin fillet e aktivitetit bankar të priftërinjëve sumeranë, ky aktivitet bankar kishte për qëllim zhvillimin e bujqësisë dhe tregtisë në vendet rrethë tempujve. Zbulime të tilla janë bërë edhe në tempujt tjerë e sidomos në Babiloni. Në tempujt e Babilonisë janë kryer punët e këmbimit të parave dhe të depozitimit, si dhe huazimi i parave me kamatë dhe kryerja e pagesave. Shtëpia më e njohur bankare e cila vepronte në Babiloni njihet me emrin MURASHO, e cila merrte para me kamatë (depozita) dhe jepte hua me kamatë (kredi) dhe mbante depo të mallrave. Në këtë kohë paraqiten edhe shtëpitë bankare të quajtur TEZAURE të cilat shtëpi bankare grumbullonin ushqimin, parat dhe gjërat tjera

---

<sup>10</sup> Dr. Safet Merovci: “Tregjet dhe instrumentet financiare”, Prishtinë, 2004, faqe 268.

<sup>11</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006, faqe 1.



dhe pastaj ato i jepnin hua me kamatë. Prej tyre edhe lindi shprehja e sotme TEZAUURIM që do të thotë tërheqja e ndnjë malli apo parave nga qarkullimi.<sup>12</sup>

Me zhvillimin e tregtisë në Greqin antike, zhvillohen edhe punët bankare. Mirëpo në Greqi i hasim paratë metalike të shumta, pasi që çdo qytet – shtet kishin paranë e vetë, ku paraqitet nevoja për të bërë këmbimin e tyre. Punët e këmbimit të parave i kryenin bankierët e kohës antike, të njohur me emrin Trapezit (trapeza – tavolina, banka ku janë kryer punët e këmbimit). Ato filluan të merren edhe me dhënien e parave hua dhe këtu shfaqet kapitali fajde dhe kamata fajde.

Pra, bankat e para ishin institucione për këmbimin e parave, të cilat tërë punën e kryenin në një tavolinë ose dyqan të vogël, i cili ishte vendosur në vendin më frekuentues, duke i ndihmuar kështu udhëtarëve që vinin në qytetet t'i ndërrojnë monedhat e huaja me paratë e vendit.<sup>13</sup>

### **5.1. Banka Qendrore**

Banka Qendrore është banka kryesore në sistemin financiar të një vendi e cila i rregullon mardhëniet monetare dhe kreditore të një vendi. Banka Qendrore si institucion financiar i sistemit monetar është e detyruar që të kujdeset për vlerën e njësisë monetare të vendit, për rregullimin e qarkullimit të parave dhe të likuiditetit të sistemit bankar si edhe për likuiditetin në vend dhe atë ndërkombëtar. Banka Qendrore është banka e vetme e autorizuar për emisionin e kartëmonedhave dhe të monedhave si mjet ligjor i pagesës në vendin përkatës.<sup>14</sup>

Zhvillimi i Bankave Qendrore ishte shumë dinamik dhe specifikë në çdo vend varësishtë nga rrethanat dhe mardhëniet ekonomike, financiare dhe politike në ekonomi dhe shoqëri. Ajo që është e përbashkët dhe karakteristike në të gjitha sistemet bankare, është vendi i

---

<sup>12</sup> Provimet.Weebly.com

<sup>13</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006, faqe 3.

<sup>14</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: “Financat”, Prishtinë, 1986, faqe 130.

tyre qendror në sistemin bankar – monetar dhe ndikimi gjithnjë më i fuqishëm, e më i madhe në ecurinë ekonomike e monetare të një vendi.<sup>15</sup>

Në zhvillim Bankat Qendrore kanë qenë shoqëri aksionare të privileguara të cilat i mbikqyrte shteti, ndërsa pas luftës së Dytë Botrore, intervenimi i shtetit në afarizmin bankar u bë gjithnjë më i madhë, që mund të shihet edhe në nacionalizmin e bankave qendrore gati në të gjitha vendet e botës. Sot kryesisht në botë mbizotron sistemi i një banke unike qendrore që në çdo vend, mirëpo ka edhe përjashtime: SHBA ekzistojnë 12 bnaka regjionale Federale Rezervë, të cilat bashkë me pleqërine e Bankës Qendrore në SHBA, kjo ndodh për shkakë të territorit të madh të SHBA-ve.<sup>16</sup>

Karakteristikë e veçantë e bankave qendrore është se qëllimi i veprimtarisë së tyre nuk është fitimi, gjë që dallohet prej bankave dhe institucioneve të tjera. Bankat emetuese në të shumtën e rastëve e mbajnë emrin e shtetit të vet, p.sh. “Banka of England”, “Banque de Franca”, “Banka d’Italia”, “Banka e Shqipëris” etj.<sup>17</sup>

Banka Qendrore kryen këto punë me rëndësi:<sup>18</sup>

- a) Bënë emisionin e parave dhe të kredisë dhe është e vetmja banke që ka të drejtë të bëjë emisionin e parave, të cilat paraqesin mjetin ligjorë të pagesës në vend.
- b) Zbaton politikën monetare – kreditore, e cila ka të bëjë me rregullimin e sasisë së parave, varësisht nga qëllimet dhe detyrat e politikës ekonomike.
- c) Kujdeset për likuiditetin ndërkombëtar, duke e përcjell vazhdimisht bilancin e pagesave.

---

<sup>15</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: “Financat”, Prishtinë, 2008, faqe 156.

<sup>16</sup> Provimet.Weebly.com

<sup>17</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: “Financat”, Prishtinë, 2008, faqe 157.

<sup>18</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006, faqe 14

## **5.2. Banka Qendrore e Kosovës**

Që nga nëntori i vitit 2000 Autoritetet Bankare dhe të Pagesave të Kosovës (tani Banka Qendrore e Republikës së Kosovës), kishte filluar së hartuari planin mbi krijimin e një sistemi të ri të Pagesave Ndërkombëtare (FMN – asistenca teknike e të cilave ishte prezente që nga fillimi) përmes këshilltarëve profesional për pagesa.

Me krijimin e Komitetit Këshillues të Pagesave Ndërkombëtare nën udhëheqjen e BQK-së në pjesmarrje të bankave komerciale, u punua rreth konkretizimit të rregullave dhe procedurave të punës, standardeve dhe të gjitha politikat tjera operationale e zhvillimore në këtë aspekt.<sup>19</sup>

### **5.2.1. Funkcionet dhe përgjegjësit e Bankës Qendrore të Kosovës**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), pasëardhëse e Autoritetit Qendrorë Bankar të Kosovës, është subjekt juridik publik i bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të depoziatve të këtij ligji, që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese.

#### **Objektivat e BQK-së sipas ligjit në fuqi janë:**

1. Objektivi parësor i Bankës Qendrore është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave,
2. Objektivi shtesë i Bankës Qendrore i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj, është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore,
3. Pa paragjykuar arritjen e këtyre objektivave, Banka Qendrore mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë,
4. Banka Qendrore vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve,

---

<sup>19</sup> <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,50>.

**Detyrat e Bankës Qendrore në përfshirjen e objektivave të përcaktuara sipas ligjit në fuqi, përfshijnë:**

1. Përcaktimin dhe zbatimin e politikave të një sistemi financiar stabil duke përfshirë mbikëqyrjen e një skeme të sigurimit të depozitave, kryerjen e një skeme të sigurimit të depozitave, kryerjen e operacioneve të tregut, si dhe ofrimin e likuiditetit emergjent,
2. Rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare ashtu si specifikohet më tej në këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër,
3. Promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë,
4. Sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Kosovë,
5. Mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave ndërkombëtare,
6. Mbledhjen dhe publikimin e statistikave,
7. Kontribuon në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore,
8. Informimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe publikut të gjerë rreth politikave, detyrave dhe operacioneve të saj ashtu siç përcaktohet më tej në këtë ligj,
9. Veprimin si bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë dhe çdo organ publik dhe organizatë publike të Kosovës.
10. Bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në këshillat dhe organizatat ndërkombëtare me çështje brenda fushës së saj të kompetencave, dhe
11. Realizimin e çdo aktiviteti ndihmës që rrjedhë nga ushtrimi i detyrave të saj sipas këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër.

Brenda kompetencave të përcaktuara me ligj, Bnaka Qendrore anëtarët e organeve vendimarrëse ose personeli i Bankës Qendrore nuk do të marrin udhëzime nga ndonjë

person apo subjekt tjetër, duke përfshirë subjektët qeveritare. Pavarësia dhe autonomia e Bankës Qendrore respektohet në çdo kohë dhe asnjë person apo subjekt qeveritar. Pavarësia dhe autonomia e Bankës Qendrore respektohet në çdo kohë dhe asnjë person apo subjekt nuk do të provojë të ndikoj anëtarët e organeve vendimmarrëse apo të personelit të Bankës Qendrore në realizimin e detyrave të tyre apo të ndërhyje në aktivitetet e Bankës Qendrore.<sup>20</sup>

### **5.2.2. Paraja ne qarkullim**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës u siguron institucioneve publike, komunitetit financiar dhe publikut shërbimet e rëndomta financiare që ofrohen nga një bankë qendrore, me përjashtim të çfarëdo krediti ose likuiditeti të përkohshëm meqë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nuk është bankë emetuese. Valuta që përdoret në Kosovë është euroja.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për sigurimin e një furnizimi të duhur të Kosovës me kartëmonedha dhe monedha euro, për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Me që euroja është valuta kryesore e lejuar për përdorim në Kosovë, përgjegjësitë e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kanë të bëjnë me euron.<sup>21</sup>

### **Institucionet e Regjistruara Financiare**

Bankat Komerciale

Kompanit e Sigurimeve

Institucionet Mikrofinanciare

Institucionet Jobankare

---

<sup>20</sup> <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,2>

<sup>21</sup> <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,24>

Agjensionet për Transfer Parash

Këmbimoret

### **5.2.3. Funkzioni statistikor i BQK-së**

Bazuar në Ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), BQK-ja grumbullon dhe përpilon statistikën për realizimin e objektivave të saja dhe më gjerë. Njëkohësisht, BQK-ja ofron edhe informacione lidhur me metodiken Statistike. Statistikat në përgjegjësi të drejtëpërdrejtë të BQK-së janë Statistikat Monetare dhe Financiare, dhe Statistikat e sektorit të Jashtëm.

Statistikat e lartëcekura janë në përputhje me standardet ndërkombëtare statistikore të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Evropiane, Eurostatit, etj. Burim i të dhënave për statistikën monetare financiare dhe të bilancit të pagesave janë: BQK-ja, bankat komerciale, korporatat tjera financiare ( kompanit e sigurimeve, fondet pensionale, etj), institucionet qeveritare, kompanitë jofinanciare, donatorët, etj. Krahas kësaj, BQK-ja ofron informacion selektiv edhe mbi sektorin fiskal dhe atë real në Kosovë.<sup>22</sup>

### **5.2.4. Sistemi Bankar në Kosovë**

Sistemi bankar në Kosovë është një sistem relativisht i ri, por që pas vitit 1999, ka shfaqur një zhvillim të shpejtë. Open Data Albania ka kryer një hulumtim mbi sistemin bankar në Kosovë, bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Aktualisht sistemi bankar përbëhet nga 8 banka:<sup>23</sup>

---

<sup>22</sup> [www.bqk-kos.org/?cid=1,118](http://www.bqk-kos.org/?cid=1,118)

<sup>23</sup> Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – Annual Report.

**Tabela.1.** Sistemi bankar në Kosovë (Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – Annual Report).

<b>Nr</b>	<b>Emri</b>	<b>Pesha në sistem</b>	<b>Origjina e Kapitalit</b>
1	Banka Ekonomike	5%	Vendas
2	Banka për Biznes	4%	Vendas
3	Procredit Bank	34%	E Huaj
4	Raiffeisen Bank Kosovo	31%	E Huaj
5	Banka Kombëtare Tregtare	3%	E Huaj
6	TEB Sh.a	6%	E Huaj
7	Komercijalna Banka ad Beograd	1%	E Huaj
8	NLB Prishtina	15%	E Huaj

I gjithë sistemi bankar kosovar është i privatizuar , dhe pjesa më e madhe e kapitalit zotërohet nga entitete të huaja (6 nga 8 banka). Numri i bankave të huaja është rritur veçanërisht në 2008, kur u shtuan edhe 2 banka të reja. Gjithashtu bankat me kapital të huaj kanë edhe pjesën më të madhe të aktivëve të sistemit (rreth 90%), ndërkohë që bankat me kapital vendas zënë vetëm 10% të totalit të aktivëve.

Vlera totale e aktivëve të sektorit bankar në Kosovë në fund të vitit 2009 vlerësohet rreth 2.2 miliarde Euro, duke paraqitur në rritje vjetore prej 21.9% (krahasuar me një vitë më parë). Bazuar në këto të dhëna vlerësohet se aktivet e sistemit bankar janë rreth 56.5% të Produktit të Brendshëm Bruto.

Aktivet e sistemit bankar gjatë viteve kanë ndryshuar sipas tabelës:<sup>24</sup>

**Tabela. 2.** Aktivet e sistemit bankar në Kosovë (Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – Annual Report).

Viti	2006	2007	2008	2009	2010
Aktivet Gjithsej (milionë Euro)	1161	1435	1808	2204	2219

Pjesa më e madhe e aktivëve të sistemit bankar e përbëjnë keditë (58.5%).

Ndërkohë në krahun e pasivit, depozitat kanë peshën më të madhe (rreth 79%), ndërkohë që kapitali aksioner zë rreth 9.3% të totalit. Krahasuar me vitin 2009, vlera totale e depozitave është rritur me rreth 21% nga viti paraardhës.

Konkretisht vlera e depozitave në sistemin bankar në Kosovë paraqitet sipas tabelës:<sup>25</sup>

**Tabela. 3.** Depozitat në sistemin bankar në Kosovë (Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Koaovës – Annual Report).

Viti	2006	2007	2008	2009	2010
Depozitat Gjithsej (milionë Euro)	924.3	1143.1	1444.1	1744.9	1752

Depozitat kanë ardhur vazhdimisht në rritje, madje edhe në vitet e krizës botërore të viteve 2008-2009.


Grafikisht vlera e aktivëve dhe depozitave gjatë viteve të fundit paraqitet sipas grafikut:<sup>26</sup>

---

<sup>24</sup> Të dhënat janë deri në qershor të vitit 2010. Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – Annual Report).

<sup>25</sup> Të dhënat janë deri në qershor të vitit 2010. Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – Annual Report).





**Fig.1.** Aktivitet dhe Depozitat e Sistemit Bankar Kosovare (Burimi: Banka qendrore e Republikës së Kosovës – Annual Report).

Një ndër problemet potenciale të sistemit bankar në Kosovë është përqëndrimi i aktivitetit në dy banka: Procredit Bank dhe Raiffeisen Bank Kosovo, të cilët së bashku kanë rreth 65% të aktiviteteve totale, gjë që ndikon negativisht në konkurrencën e sistemit bankar.

<sup>26</sup> Të dhënat janë deri në qershor të vitit 2010. Burimi: Banka qendrore e Republikës së Kosovës – Annual Report.

## 6. INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE

Institucionet financiare jobankare, janë shoqëri të cilat kryejnë aktivitete të ndërmjetësimit financiar dhe aktivitete të tjera ndihmëse, të lidhuar ngushtë me ndërmjetësimin financiar por që nuk klasifikohen si pranues depozitash. Disa nga këto aktivitete përfshijnë: lansing, investimi në letra me vlerë etj.<sup>27</sup>

Ekzistojnë pesë grupe kryesore të këtyre institucioneve financiare:

- a) Organizatat financiare depozituese.
- b) Institucionet për kursimin e kontraktuar.
- c) Organizatat financiare investive.
- d) Kompanit financiare.
- e) Organizatat financiare të përziera.

### **6.1. Organizatat financiare depozituese**

Në këtë grup hyjnë korporativat kursimore – kreditore dhe shërbimet kursimore – kreditore (merren me ruajtjen e mjeteve monetare, kamatizimin e tyre, si dhe lejimin e kredive nga ato mjete të anëtarëve të vet.

### **6.2. Institucionet për kursimin e kontraktuar.**

Këtu hyjnë institucionet që bëjnë kursimin e kontraktuar (organizatat e sigurimit dhe fondet e pensioneve).

---

<sup>27</sup> Open.data.al.

### **6.3. Organizatat financiare investive**

Këto organizata formojnë potencialin e tyre në bazë të lëshimit apo transferit të letrave afatëgjate, me vlerë (stocks and bonds). Në ekonomitë e zhvilluara të tregut, në këto organizata hyjnë: fondet e përziera, kompanitë investive, fondet personale e fondet e përbashkëta kujdestare dhe kompanitë kujdestare.

### **6.4. Kompanitë financiare**

Këto kompani i formojnë mjetet për afarizmin e vet nga letrat komerciale me vlerë, kreditë bankare e aksionet.

### **6.5. Organizatat financiare të përziera**

Këto organizata financiare të përziera përfshijnë agjencionet kreditore shtetërore për formimin e aranzhimeve, shtëpitë bankare për stimulimin e investimeve financiare etj.<sup>28</sup>

Një sistem shumë i zhvilluar i institucioneve financiare jobankare ekziston në shtetet ekonomikisht të zhvilluar, ndërsa në vendet e tjera kjo strukturë është e pazhvilluar, prandaj në këto vende bankat kanë monopol në fushën financiare dhe i kryejnë të gjitha punët financiare. Në ekonominë e zhvilluar ekziston dhe zhvillohet konkurrenca në mes të bankave e institucioneve financiare jobankare, gjë që mundëson krijimin dhe funksionimin e një sistemi financiar vital, elastik dhe racional.

Në ekonominë e zhvilluar, sidomos në SHBA dhe Britaninë e Madhe, bankat afariste në fillim të shekullit XX kanë marrë pjesë në potencialin e tërësishëm me 70%, ndërsa organizatat jofinanciare me rreth 30%. Në vitet 60 – të, bankat marrin pjesë me 40%, ndërsa institucionet jobankare me 60%. Vitet e fundit bankat përsëri e kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në potencialin e tërësishëm financiar të ekonomisë.<sup>29</sup>

Në vendet në zhvillim, që kanë ekonomi të pazhvilluar (Kosova), paraqitet sistemi bankar jo mjaftë i zhvilluar, me dy funksione klasike: grumbullimi i depozitave dhe dhënia e

---

<sup>28</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 25.

<sup>29</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: "Financat", Prishtinë, 2008, faqe 26.

kredive, ndërsa institucionet jobankare mbesin të pazhvilluara. Kjo vlenë edhe për institucionet financiare, prandaj mund të thuhet se struktura financiare në këto vende ka mbetur e pazhvilluar, gjë që është e kuptueshme, pasi këtu është karakteristik niveli i ultë i të ardhurave, mungesa e kursimit, orientimi drejt konsumit, mungesa e traditës, mosbesimi në institucionet financiare, papunësia e lartë, problemet sociale, etj.<sup>30</sup>

## 7. INSTITUCIONET QENDRORE TË QARKULLIMIT TË PAGESAVE

Institucionet qendrore të qarkullimit të pagesave të krahinave (Landersbanken Girozentrale) kanë funksionin e bankave qendrore për bankat e kursimeve nga regjionet gjegjëse si dhe të bankave komerciale nga regjionet gjegjëse si dhe të bankave komerciale të shtetit të caktuar.

Këto institucione veprojnë si shtëpi kliringe të bankave të kursimeve, që i sigurojnë me të gjitha shërbimet e qarkullimit të pagesave, i ruajnë rezervat likuide të bankave të kursimeve, kryejnë shërbime si: pagesa me jashtë (për të cilat bankat e kursimeve nuk kanë leje), bëjnë operacione me letra me vlerë, sigurojnë ndikime teknike dhe këshilla në menaxhmentin investiv, kryejnë lizingun, faktoringun dhe përpunimin e të dhënave.<sup>31</sup>

### 7.1. Gjiro institucionet qendrore dhe bankat e kursimeve

Për këto banka është karakteristikë që si garancë paraqesin krahinat, përkatësisht komunat dhe qytetet, në territorinë e të cilëve punojnë. Fondi për sigurimin e depozitave të bankave të kursimeve dhe fondi për sigurimin e depozitave të gjiro institucioneve qendrore, janë të lidhura midis tyre. Te fondi për bankat e kursimeve investohet gjithnjë deri sa mjetet arrijnë lartësinë prej 0.15% të shumës së përgjithshme të kredive jobankare për gjithë sistemin bankar. Banka vë peng 0.15% mjete plotësuese në formë të garanceës, që do të jenë në dispozicion në rast nevojë. Fondi për sigurimin e depozitave, siguron edhe solventitetin e bankës.

---

<sup>30</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 27.

<sup>31</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 64.

Fondi për sigurimin e depozitave në gjiro institucionet qendrore dallohet nga se më shumë vëmendje i kushton mbrojtjes së depozitorëve.

Gjiro institucionet qendrore investojnë 0.05% në vite nga vlera e depozitave jobankare me 0.05 % mjete plotësuese në formë garance deri sa të arrihet niveli prej 1%, nga vlera e depozitave jobankare.<sup>32</sup>

## 8. ORGANIZATAT FINANCIARE N DËRKOMBËTARE

Institucionet e para financiare ndërkombëtare i hasim pas Krizës së Madhe të vitit 1929. Nevoja për themelimin e institucioneve financiare ndërkombëtare, të cilat do të ndikonin në tejkalimin e çrregullimeve financiare dhe ripërtrirjen e ekonomive të shkatërruara nga lufa.

Planet për rregullimin e Pagesave ndërkombëtare i hartuan SHBA (Plani i White – it) dhe Anglia (Plani i Keynes – it). Që të dy planet kishin për qëllim që të vendosin bazat për formimin e institucioneve financiare, të cilët me aktivitetin e tyre, do të siguronin stabilitetin dhe sigurinë në pagesat ndërkombëtare. Mbi këtë bazë u hartua propozimi i ekspertëve të më se 30 vendeve, i cili shërbeu si bazë për Konferencën monetare e financiare, që u mbajt në Bretton – Woods prej 1 deri 22 Korrik të vitit 1944.<sup>33</sup>

Në bazë të këtij propozimi, u morë edhe vendimi për themelimin e dy institucioneve financiare ndërkombëtare, e që quhet “Institucionet e Bretton Woods – it”: Fondi Monetar Ndërkombëtar (International Monetary Fund – IMF) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (International Bank of Reconstruction and Development – IBRD).

Pas themelimit të këtyre dy institucioneve, u paraqit nevoja edhe për themelimin e institucioneve të reja të specializuara, të cilat do të financojnë zhvillimin e ndërmarrjeve private në vendet anëtare të Bankës Botrore dhe zhvillimin ekonomik të vendeve më pak të zhvilluar. Kështu u themeluan edhe dy institucione të specifikuar të Bankës Botrore:

---

<sup>32</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006, faqe 72.

<sup>33</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni “Financat”, Prishtinë, 2008, faqe 147.

Korporata Financiare Ndërkombëtare (International Financial Corporation – IFC) dhe Shoqata Ndërkombëtare për zhvillim (International Development Association – IDA).<sup>34</sup>

### **8.1. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ose (IMF)**

Fondi Monetar Ndërkombëtar është krijuar me qëllim të promovimit të ekonomisë së shëndosh botërore. Selia e Fondit gjendet në Washington DC, dhe udhëheqet prej Guvernatorëve të 184 vendeve anëtare.<sup>35</sup>

Fondi Monetar Ndërkombëtar është themeluar në Bretton – Woods të SHBA-së në vitin 1944.<sup>36</sup> Për themelimin e FMN-së ishin hartuar dy propozime: Plani i Keynes – it dhe Plani i White – it.

Plani i Keynes-it bazohej në përvojat e Anglisë që nga kriza botërore e vitit 1931 e këndej, kur funksiononte zona e funtës. Ky plan propozonte që të eliminohet ari nga pagesat ndërkombëtare dhe të formohet Unioni Kliring Ndërkombëtar, i cili do të bazohej në llogarinë bankare multilaterale, ku valuta përlllogaritëse do të ishte paraja ndërkombëtare “Bankor”, ari bankar dhe përkohësishtë të mbahen kufizimet në qarkullimin e mallrave dhe të pagesave në suaza ndërkombëtare.<sup>37</sup>

Plani i White-it bazohej në potencialin e madhë ekonomik të SHBA-së, dollarin konvertibil dhe rezervat më të mëdha të arit në botë. Ky planë propozonte lejimin e tregtisë së lirë dhe kthimin në standardin e arit, gjë që i konvenonte interesave të SHBA-së.<sup>38</sup>

Qëllimi i këtij institucioni monetar ndërkombëtar ishte që të zhvillojë bashkëpunim monetar ndërkombëtar të zgjerojë mundësitë e zhvillimit të tregëtisë botërore, të

---

<sup>34</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006, faqe 36)

<sup>35</sup> International Monetary Fund. Annual Report – 2005

<sup>36</sup> Sq.Wikipedia.org/Wiki/Fondi\_Monetar\_Nderkombetar.

<sup>37</sup> Provimet.Weebly.com

<sup>38</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006, faqe 37.

ndihmojë në stabilizimin e kurseve devizore, të zhvillojë sistemin multilateral të pagesave dhe të eliminojë kufizimet devizore, të ndihmojë shtetet anëtare për tejkalimin e vështirësive të përkohëshme në bilancin e pagesave duke u dhënë kredi.<sup>39</sup>

**Mjetet financiare të FMN-së** – krijohen me participimin e vendeve anëtare në formë të kuotave, dhe lartësia e kuotës caktohet për çdo vend veç e veç në bazë të disa treguesve makroekonomik p.sh: të ardhurat nacionale, importi, eksporti, rezervat devizore konvertibile, etj.

**Organi më i lartë i FMN-së** – është këshilli i Guvernatorëve, ku marrin pjesë nga një Guvernator i çdo vendi anëtarë, dhe i cili këshill mbledhet zakonisht 1 herë në vitë me që rast ata mund të vendosin për: pranimin e anëtarëve të rinjë, përjashtimin e anëtarëve të FMN-së, ndërrimin e lartësisë së kuotës, etj.

**Organi ekzekutiv i FMN-së** – është Këshilli i Drejtorëve Ekzekutiv i cili përbëhet prej 19 drejtorëve ekzekutiv, 5 prej të cilëve i emërtojnë vendet me kuota më të mëdha si SHBA, Britani e Madhe, Gjermania, Franca dhe India, kurse drejtorët e tjerë zgjidhen nga vendet e tjera anëtare. Këtë këshill e udhëheqë drejtori gjeneral i fondit të cilin e zgjedhin drejtorët ekzekutivë.<sup>40</sup>

## **8.2. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)**

Që nga themelimi (1 – 22 Korrik 1944), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), është rritur nga një institucion i vetëm, në një bashkësi prej pesë institucionesh të mëdha ndërkombëtare zhvillimore ngusht të lidhura me njëra – tjetrën, dhe sotë numëron 184 anëtar.<sup>41</sup> Misioni i Bankës Botërore ka evoluar nga misioni i rindërtimit dhe zhvillimit pas Luftës së Dytë Botërore, deri te mandati i sotëm për zvogëlimin e varfërisë, dhe zhvillim të vendeve të pazhvilluara dhe vendeve në zhvillim anembanë botës bashkë me afilacionet tjera.

---

<sup>39</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kunomi: “Financat”, Prishtinë, 1986, faqe 148.

<sup>40</sup> Provimet.Weebly.com/Organizatat\_Financiare\_Nderkombetare.

<sup>41</sup> Annual Report, World Bank – 2005.

Detyrat themelore të Bankës Botërore janë:

- a) ndihma e vendeve anëtare për zhvillimin e tyre ekonomik,
- b) nxitja e investimeve ekonomike në botën e jashtme,
- c) zhvillimi afatëgjatë i tregëtisë ndërkombëtare,
- d) financimi i projekteve prioritare të zhvillimit ekonomik të vendeve anëtare,
- e) harmonizimi i veprimtarisë së saj me gjendjen dhe rrethanat në vendet që financohen.

Përpos këtyre funksioneve themelore, Banka Botërore kryen edhe punë të tjera, siqë janë:

- a) organizimi dhe dhënia e ndihmës financiare,
- b) aftësimi i kuadrove në kuadër të Institutit për Zhvillim Ekonomik,
- c) themelimi i konsorciumeve për kreditimin e programeve të zhvillimit.

Banka Botërore i krijon mjetet nga kuatat e vendeve anëtare. Pjesëmarrja e vendeve anëtare përbëhet nga dy pjesë: nga kapitali i paguar 20% dhe kapitali kryesorë 80%. Kapitali kryesorë nuk paguhet dhe shërben si kapital garantues i bankës, të cilin do ta paguanin vendet anëtare nëse paraqitet nevoja për kryerjen e obligimeve të Bankës ndaj besorëve dhe nëse kapitali i paguar (20%) nuk mjafton.<sup>42</sup>

Pos kapitalit të vetë, për realizimin e funksioneve të saj Banka Botërore shfrytëzon edhe mjetet e mobilizuara në tregun e kapitalit, prandaj mund të themi se burimet kryesore të mjeteve financiare janë:

1. Kapitali i deponuar ose paguar,
2. Kapitali garantues,
3. Mjetet e mbledhura në tregun e kapitalit,

---

<sup>42</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006. faqe 39.



4. Mjetet nga të hyrat e realizuara,
5. Mjetet nga kryegjëja e huave të dhëna më parë.

### **8.2.1. Kapitali i deponuar ose pagues**

Kapitali i deponuar ose pagues (20%), paraqet kapitalin që e paguan çdo anëtar i Bankës Botërore, dhe ky kapital përbëhet prej 2 pjesëve, (2% - deponohet në ari ose dollarë të SHBA-së, dhe këtë shumë Banka Botërore mund ta shfrytëzoj për financimin e punëve të saj, dhe 18% - deponohet në valutë të vendit anëtar, ndërsa këtë shumë Banka Botërore mund ta shfrytëzojë vetëm me pëlqimin e vendit anëtar, valuta e së cilës është në pyetje).

### **8.2.2. Kapitali garantues**

Kapitali garantues (80%), paraqet pjesë tjetër të participimit të çdo vendit anëtar të Bankës Botërore (80%), dhe ky kapital paraqet vetëm me kërkesën e Bankës Botërore dhe nëse paraqitet nevoja për ruajtjen e likuiditetit të Bankës Botërore ndaj besorëve (keditorëve) të saj.

### **8.2.3. Mjetet e mbledhura në tregun e kapitalit**

Mjetet e mbledhura në tregun e kapitalit Banka Botërore i siguron mjetet financiare edhe përmes tregut të kapitalit, duke bërë emetimin e fletëobligacioneve dhe boneve, të cilat emetohen në dollarë, franga zvicerane dhe marka gjermane. Pjesa më e madhe e huave sigurohet në tregun e kapitalit amerikan (57%), kurse pjesa tjetër në vendet tjera të botës.<sup>43</sup>

---

<sup>43</sup> Provimet.Weebly.com/

#### **8.2.4. Mjetet nga të hyrat e relizuara**

Mjetet nga të hyrat e realizuara nga Banka Botërore. Këtu hyjnë kamatat e arkëtuara dhe provizionet për kreditë e dhëna, garancitë dhe mjetet e angazhuara e të pashfrytëzuara.

#### **8.2.5. Mjetet nga kryegjëja e huave të dhëna më parë**

Mjetet nga kryegjëja e huave të dhëna më parë paraqesin po ashtu burimet për lejimin e kredive të reja vendeve anëtare. Në këtë mënyrë Banka i ripërtrinë burimet e mjeteve të saj.<sup>44</sup>

Duhet potencuar se Banka Botërore u jep kredi vendeve anëtare vetëm me garantimin e qeverisë së vendit të cilit i lejohet kredia. Gjatë kreditimit Banka Botërore u përmbahet parimeve të caktuara:

- a) që projektet të jenë rentabile,
- b) financon vetëm një pjesë të projektit (zakonisht paisjet që duhet të blehen në botën e jashtme),
- c) financohen vetëm projektet që ndikojnë në zhvillim,
- d) kredija lejohet vetëm kur vërtetohet se ajo nuk ka mundur të mirret nga institucionet tjera financiare me kushte më të volitshme.

Kreditë zakonisht jepen për financimin e projekteve të energjetikës, për zhvillimin e bujqësisë, industrisë, turizmit etj, në afat prej 15 – 35 vjet dhe me normë të kamatës prej 3 – 10%.<sup>45</sup>

Organi më i lartë udhëheqës i Bankës Botërore është Pleqësia e Guvernatorëve, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e çdo shteti – anëtar. Zakonisht anëtarët janë ministrat e financave apo guvernatorët e Bankës Botërore të vendeve anëtare. Ky këshill vendos mbi parimin e anëtarëve të rinjë, përcakton kushtet për pranimin e anëtarëve të rinjë, për

---

<sup>44</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 41.

<sup>45</sup> Peovimet.Weebly.com/

përrjashtimin e anëtarëve, për lartësin e kapitalit, për ndarjen e fitimit, etj. Pleqësia e Administratës përbëhet prej 17 drejtorëve ekzekutive, 5 prej të cilëve i zgjedhin vendet anëtare me kuotën më të madhe, kurse 12 të tjerë i zgjedhin guvernatorët e vendeve tjera anëtare me shumicë votash. Kryetari i Bankës Botërore udhëheqë Pleqësinë e Administratës dhe punët e tjera të bankës në bazë të politikës të përcaktuar nga Pleqësia e Guvernatorëve.<sup>46</sup>

### **8.3. Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC)**

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), është institucion financiar i specializuar i OKB-së, e cila është organizuar si degë e Bankës Botërore. Është themeluar në vitin 1956 me seli të përhershme në Washington DC. Si anëtar të Korporatës mund të jenë vetëm shtetet anëtare të Bankës Botërore.<sup>47</sup>

Korporata Financiare Ndërkombëtare është themeluar me qëllim që ti ndihmojë ndërmarrjet private, ku investohet në ndërmarrje private prodhuese pa garancinë e shtetit si Banka Botërore, Korporata Financiare Ndërkombëtare nuk u jep kredi ndërmarrjeve shtetërore (publike). Pra, qëllimi i themelimit të Korporatës ishte që të plotësohet puna e Bankës Botërore, duke investuar direkt në ndërmarrjet private pa garanci të qeverisë ose shtetit.<sup>48</sup>

Kapitali i saj në fillim ishte rreth 100 milion dollarë, dhe atë e kanë paguar vendet anëtare, mirëpo korporata mund të sigurojë mjete edhe me emetimin e fletëobligacioneve dhe boneve, gjithashtu ajo mund të huazojë mjetet nga Banka Botërore në lartësi herë më të madhe se që është kapitali i saj. Statusi i saj është skeptik, ajo është organizatë e pavarur me kapitalin e saj, afarizmin udhëheqjen dhe personelin, mirëpo në pikpamje organizative është e lidhur ngusht me Bankën Botërore. Pleqësia e Guvernatorëve dhe Pleqësia e Administratës janë njëkohësisht organet më të larta të Korporatës. Kjo

---

<sup>46</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: "Financat", Prishtinë, 1986, faqe 150.

<sup>47</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: "Financat", Prishtinë, 1986, faqe 150.

<sup>48</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni: "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 42.

korporatë merr pjesë zakonishtë gjatë financimit të projekteve deri në 50 % të vlerës së tyre. Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) jep kredi me afat 7 – 15 vjet, varësisht nga llojet e projekteve, dhe duhet potencuar se kthimi i huasë fillon pasi të kryhet objekti i financiar dhe pasi të fillojë prodhimi i rregullt.<sup>49</sup>

#### **8.4. Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)**

Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), është institucion financiar që u themelua në vitin 1960 si filialë e specializuar e Bankës Botërore për të ndihmuar zhvillimit ekonomik të vendeve në zhvillim. Kjo organizat u themelua, pasi vendet e pazhvilluara nuk mund t'i shfrytëzonin kreditë e Bankës Botërore në rastet kur kishin nevojë për financimin menjëher mjetet financiare për kthimin e kredisë në valutë konvertibile, mirëpo këto projekte ishin parakusht për realizimin e projekteve rentabile.<sup>50</sup>

Qëllimi i Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) është që ti ndihmojë vendet e pazhvilluara nëpërmjetë kreditimit të projekteve kryesore për zhvillimin e tyre, siqë janë: energjetika, infrastruktura, bujqësia, arsimiti, shëndetësia, etj. Këto kredi jepen me kushte shumë të volitshme, pa kamatë, me një provizion të vogël (0.75%) dhe me afat të kthimit deri në 50 vjet.

Mjetet e Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim krijohen me participimin e vendeve anëtare në formë të kuotave, nga mjetet që i deponojnë vendet e pazhvilluara, nga kontributet e veçanta të disa vendeve anëtare, etj. Vendet e zhvilluara pagesën e kuotës e bëjnë në deviza dhe ari, kurse vendet e pazhvilluara 10% në valutë konvertibile, kurse 90% në valutë të vendit. Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim është e liruar nga pagimi i të gjitha tatimeve e taksave që kanë të bëjnë me afarizmin e saj. Kështu Pleqësia e Guvernatorëve dhe Pleqësia e Administratës së Bankës Botërore janë njëkohësisht edhe të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.<sup>51</sup>

---

<sup>49</sup> Provimet.Weebly.com/

<sup>50</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 43.

<sup>51</sup> Provimet.Weebly.com/

## 9.ORGANIZATAT FINANCIARE REGJIONALE

Karakteristikë e orgatizatave financiare regjionale është se ato e kryejnë aktivitetin e tyre në një vend të caktuar, por për një grup të shteteve të cilat në pikpamje ekonomike ose praktike janë të lidhura me interes reciprok. Në grupin e organizatave financiare regjionale hyjnë:<sup>52</sup>

1. Banka për Likuidimin e Llogarive Ndërkombëtare,
2. Banka Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ekonomik,
3. Unioni Evropian i Pagesave,
4. Banka Investive Evropiane,
5. Banka Ndërkombëtare Investive,
6. Banka Interamerikane për Zhvillim,
7. Banka Afrikane për Zhvillim,
8. Banka Islamike për Zhvillim,
9. Banka Arabe për Zhvillim Ekonomik,
10. Banka Aziatike për Zhvillim.

### **9.1. Banka për Likuidimin e Llogarive Ndërkombëtare**

Banka për Likuidimin e Llogarive Ndërkombëtare është themeluar para Luftës së Dytë Botërore në Bazel të Zvicrrës, në periudhën e krizës së madhe ekonomike të vitit 1930. Qëllimi i themelimit të saj ishte realizimi i planit për pagimin e reparacioneve (dëmshtëpërblimeve) gjermane nga Lufta e Parë Botërore. Detyra e Bankës ishte sigurimi dhe përparimi i bashkëpunimit në mes të bankave qendrore, lejimi i kredive afatëshkurtër i bankave qendrore, etj.

---

<sup>52</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni "Financat", Prishtinë, 1986, faqe 152.

## **9.2. Banka Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ekonomik (KNER)**

Banka Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ekonomik (KNER), është themeluar më 1963 në Moskë. Detyra kryesore e saj ishte që të bëjë kalkulimin multilateral në rubla transferabile në mes të vendeve anëtare nëpërmjet llogarisë kliringe. Borxhet dhe kërkesat e përkohëshme janë likuiduar me ndërmjetësimin e Bankës.<sup>53</sup>

## **9.3. Unioni Evropian i Pagesave**

Unioni Evropian i Pagesave u themelua në qershor të vitit 1950 dhe kishte 17 vende anëtare të Bashkëpunimit Ekonomik Evropian (BEE). Detyra kryesore e Unionit ishte lehtësimi i pagesave të solldove debitore apo kreditore, të krijuara nga pagesat ndërkombëtare të vendeve anëtare.

Pagesat në mes të vendeve anëtare janë bërë me ndërmjetësimin e Unionit Evropian të Pagesave dhe është zbatuar kliringu multilateral, ku salldoja e një vendi anëtar është likuiduar së bashku me salldon e të gjitha vendeve. Ky Union u shua me 1958 pasi që çdo shtet anëtarë e shpalli konvertibilitetin e valutave të tyre.<sup>54</sup>

## **9.4. Banka Investive Evropiane (EIB)**

Banka Investive Evropiane (EIB) u themelua në vitin 1958 së bashku me themelimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane (BEE), kurse punën e filloi me 1959 me seli në Bruksel, dhe ajo kishte karakter regjional.

Qëllimi i saj ishte financimi i projekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluara të Bashkimit Ekonomik Evropian (BEE). Kapitali i bankës në fillim ishte 1 miliardë njësi llogaritëse e cila njësi ishte e barabartë me 0,88867 gramë ari të pastër, e që ishte paguar 25% në ari dhe valuta konvertibile dhe 75% në valutë kombëtare të vendeve anëtare. Mjetet banka i ka krijuar nëpërmjet pagimit të kuotave të vendeve anëtare dhe përmes shitjes së obligacioneve në Tregun e Përbashkët.

---

<sup>53</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 45.

<sup>54</sup> Provimet.Weebly.com/

Përfshirja e sektorit financiar dhe të bizneseve, qeverive, punonjësve dhe shoqërit civile që kanë punuar për tregun e përbashkët është e rëndësishme për një institucion publik si Banka Investive Evropiane. Kredit u akordohen vendeve joanëtare para së gjithash për financimin e projekteve infrastrukturore, ndërtimi i të cilave është me interes për vendet e BEE-së.<sup>55</sup>

### **9.5. Banka Ndërkombëtare Investive (IIB)**

Banka Ndërkombëtare Investive u themelua në vitin 1970 në Moskë, anëtarët e saj ishin vendet e KNER-it, por mund të anëtarësoheshin edhe vendet e tjera që i pranonin parimet e afarizmit të Bankës Ndërkombëtare Investive. Kjo Bankë lejonte kredi investive për ndërtimin e objekteve ekzistuese.<sup>56</sup>

### **9.6. Banka Interamerikane për Zhvillim**

Banka Interamerikane për Zhvillim u themelua në vitin 1960 me seli në Washington dhe anëtarët e saj janë: Kuba, SHBA dhe shtetet e Amerikës së Mesme dhe të Jugut. Qëllimi i themelimit të Bankës Interamerikane për Zhvillim është që në Amerikën Latine të bëjë financimin e zhvillimit si dhe të dhënies së ndihmës teknike për realizimin e projekteve për zhvillim në këtë pjesë të botës.

Qëllimi tjetër i kësaj Banke është dhënia e kredive, garancioneve, financimi i vendeve anëtare si dhe nxitja e investimeve të kapitalit publik dhe privat. Në fillim kapitali i saj ishte 1 miliardë dollarë, por ai u rrit disa herë më vonë. Mjetet e Bankës ndahen në mjetet e fondit themelor dhe në mjetet e fondit për punë specifike.

Mjetet e fondit themelor banka i jep për një afat prej 15 – 20 vjet, kuse kredinë prej mjeteve të fondit për punë specifike e lejon me kushte shumë më të volitshme (20 – 30 vjet) dhe me kamat të ulët (1 – 4%).

---

<sup>55</sup> [www.eib.org/about/structure/index.htm](http://www.eib.org/about/structure/index.htm).

<sup>56</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006, faqe 46.

Anëtarët tjerë të Bankës Interamerikane për Zhvillim janë: Anglia, Danimarka, Gjermania, Izraeli, Japonia, Spanja, Belgjika dhe Zvicra.<sup>57</sup>

### **9.7. Banka Afrikane për Zhvillim (ADB)**

Banka Afrikane për Zhvillim është institucion financiar i cili u themelua në vitin 1963 në Kartun të Sudanit në Konferencën e ministrave financiar të vendeve Afrikane. Kjo bankë u themelua për nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendeve afrikane dhe për të mundësuar integrimin ekonomik në mes të vendeve afrikane.

Themelues të bankës janë shtetet e ligës Arabe, kurse mjetet e saj mund t'i shfrytëzojnë të gjitha vendet e Afrikës që nuk janë anëtare të Ligës Afrikane. Kapitali i Bankës në fillim ishte mjaftë i vogël (250 milion dollarë). Gjysma e kapitalit është paguar në ari ose valutë konvertibile, kurse gjysma tjetër ka shërbyer si kapital garantues dhe atë e paguajnë vendet anëtare kur të ketë nevojë Banka për to. Në vitin 1972 kjo bankë themeloi Fondin Afrikan për Zhvillim i cili i jep kredi vendeve anëtare me kushte të volitshme (50 vjet, pa kamatë dhe me një provision shumë të ulët).<sup>58</sup>

### **9.8. Banka Islamike për Zhvillim (IDB)**

Banka Islamike për Zhvillim është themeluar në vitin 1974 në Xhed të Arabisë Saudite. Vendet anëtare ishin 24 shtetet arabe dhe islamike, kurse sotë numri i anëtarëve arrin 30 shtete.

Qëllimi i Bankës Islamike për Zhvillim është dhënia e kredive për financimin e projekteve si dhe të programeve të zhvillimit të shteteve anëtare. Kreditë jepen pa kamatë, me një provision shumë të ulët për mbulesën e shpenzimeve. Kreditë u jepen qeverive të shteteve anëtare ose institucioneve publike.<sup>59</sup>

---

<sup>57</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni "Financat", Prishtinë, 1986, faqe 155.

<sup>58</sup> Provimet.Weebly.com/

<sup>59</sup> Prof. Dr. Sabahudin Kumoni "Financat", Prishtinë, 1986, faqe 156.



### **9.9. Banka Arabe për Zhvillim Ekonomik (ABED).**

Banka Arabe për Zhvillim Ekonomik (ABED), është themeluar në vitin 1973 në Kartun të Sudanit. Qëllimi i saj ishte që të zhvillojë ekonominë e vendeve afrikane, duke financuar objektet e ndryshme me interes të posaçëm për zhvillimin regjional të vendeve afrikane.

Themelues të Bankës janë shtetet e Ligës Arabe, kurse mjetet e saj mund t'i shfrytëzojnë të gjitha vendet e Afrikës, të cilat nuk janë anëtare të Ligës Arabe. Kreditë kryesisht u lejojnë institucioneve kombëtare për zhvillim me kushte shumë të volitshme (me afat prej 25 vjetësh, 1 – 6% me kamatë dhe me obligim të fillimit të kthimit të kredisë 5 vjet pasi të jetë shfrytëzuar ajo).<sup>60</sup>

### **9.10. Banka Aziatike për Zhvillim (ADB)**

Banka Aziatike për Zhvillim (ADB), është një institucion financiar i zhvillimit shumëpalësh, misioni i të cilit është për ta ulur varfërinë në rajonin e Paqësorit Aziatik. Eshe pse Banka Aziatike për Zhvillim (ADB) pretendimet për të vepruar në interes të qytetarëve më të varfër të Azisë, grupet e shoqërisë civile kanë qenë prej kohësh të shqetësuar për ADB në promovimin e rritjes së qëndrueshme të barabartë në rajon.<sup>61</sup>

Banka Aziatike për Zhvillim u themelua në vitin 1965 në Manile (Filipine). Anëtarët e saj ishin 22 shtete të Azisë dhe Lindjes së Largët, por në të mund të hynin edhe vendet e zhvilluara të regjioneve të tjera.

Qëllimi kryesor i Bankës Aziatike është që ta nxisë grumbullimin e kapitalit për financimin e zhvillimit të vendeve të pazhvilluara. Kapitali fillestar i bankës është 1 miliardë dollarë edhe ky kapital u rrit disa herë, rritjen e kapitalit Banka e bënë duke emetuar obligacione në tregun e kapitalit. Kapitali i bankës është formuar nga pagesat e vendeve anëtare (50% në ari ose valut konvertibile dhe 50% në valut të vendit). Duhet

---

<sup>60</sup> Prof. Dr. Gazmend Luboteni "Bankat dhe afarizmi bankar", Prishtinë, 2006, faqe 49.

<sup>61</sup> [www.bicusa.org/en/institution.2.aspx?](http://www.bicusa.org/en/institution.2.aspx?)

potencuar se në vitin 1973 e themeloi Fondin Aziatik për zhvillim i cili u jep kredi vendeve anëtare me kushte më të volitshme (për 40 vjet dhe me 1% kamatë).

## 10. PËRMBAJTJA E SIGURIMEVE INSTITUCIONALE

Kuptimi sigurim nga aspekti shkencor si kategori ekonomike e prodhimeve të mallrave, është mënyra e posaçme e sigurimit të mjeteve monetare (fondi monetar), përmes bashkimit të mjeteve. Në këtë mënyrë krijohen mjete me qëllim që të shpërndahen dëmet nëpër shumë subjekte tek të cilat ekziston rreziku nga dëmet.

Më së shpeshti, sigurimi si kategori ekonomike e prodhimit të mallrave definohet si vijon: sigurimi paraqet mbi bazë vullnetare ose të obligueshme formë të organizuar të formimit kolektiv të mjeteve monetare për sigurim (fondi për sigurim), në bazë të parimeve të reciprocitetit dhe solidaritetit përmes bashkimit të mjeteve me ndërmjetësimin e institucioneve të specializuara.<sup>62</sup>

Sigurimi është institucion i cili i kompenzon dëmet e krujuara në një shoqëri në kuadër të ekonomisë së tij ose tek njerëzit për shkak të veprimit të stuhive natyrore dhe rasteve të fatëkeqësisë.

Sigurimi organizon për përmbajtjen e pasurive ekonomike të cilat do të humben nën veprimtarin e stuhive. Sipas saj, sigurimi është një institucion ekonomik për kompenzimin e dëmeve, të krijuara për shkakë të stuhisë dhe ngjarjeve të tjera të jashtëzakonshme, gjithashtu edhe nga rastet e fatëkeqësisë, të cilave u janë nënshtruar individët dhe shoqërit. Sigurimin e përbënë bashkësia e të rrezikuarve, reciprociteti dhe lidhshmëria e tyre me qëllim të sigurimit të mjeteve monetare për rastet e krijimit të dëmeve ekonomike të një anëtari të caktuar nga një bashkësi.<sup>63</sup>

---

<sup>62</sup> Dr. sc. Xhevat Bakraç: "Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimi", Prishtinë, 2004, faqe 7.

<sup>63</sup> Dr. sc. Xhevat Bakraç: "Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimi", Prishtinë, 2004, faqe 11.

## 10.1. Shoqërit e sigurimit të jetës dhe pasurisë.

Shoqërite (kompanitë) e sigurimeve janë ndërmjetës financiar të cilët për një çmim që përcaktohet nëpërmjet një kontrate sigurimi e që mëshirohet në polisën e sigurimit, do të bëjnë pagesa zhdëmtimi në rast të aksidentëve dhe dëmtimeve të ndaluara dhe në rast vdekje të palës së siguruar.<sup>64</sup>

Ekzistojnë dy lloje të kompanive të sigurimeve:

- a) kompanitë e sigurimit jetësorë,
  - b) kompanitë e sigurimit të pasurisë.
- a) Kompanitë e sigurimit jetësorë** obligohen që poseduesit të polisës t’i paguajnë një shumë të caktuar parash, ose një seri pagesash për ata që kanë përfitime nga polisa pas vdekjes së poseduesit të polisës.

Pjesa me e madhe e biznesit të kompanive të sigurimit të jetës është në fushat e ofrimit të beneficioneve personale, respektivisht në menaxhimin e fondeve personale, veçmas në menaxhmentin e portofolit.

- b) Kompanitë e sigurimit të pasurisë** ofrojnë gamë të gjerë të zhdëmtimeve kundrejt llojeve të shumta të ndodhive (ngjarjeve të pa dëshirueshme – aksidenteve). Ndodhjet mund të jenë: humbjet dëmtimet ose shkatrrimet e pasurisë, dëmet, ose humbjet e mjeteve prodhuese (që gjenerojnë të ardhurat), kërkesat për dëmet ndaj palës së tretë për shkak të neglizhencës së supozuar, humbjet nga dëmtimet – lëndimet dhe vdekjet aksidentale.

Investimet më të mëdha të kompanive të sigurimit të jetës bëhen në letra me vlerë të korporatës (obligacione, aksione).<sup>65</sup>

---

<sup>64</sup> Dr. Safet Merovci: “Tregjet dhe instrumentet financiare”, Prishtinë, 2004, faqe 268.

<sup>65</sup> Dr. Safet Merovci: “Tregjet dhe instrumentet financiare”, Prishtinë, 2004, faqe 269.

## 10.2. Fondet e pensioneve

Fondi i pensioneve është fond i cili krijohet për pagimin e përfitimeve pensionale. Pra, është një shoqëri, një kompani financiare e cila grumbullon kontributet – me pagesa javore ose mujore, nga individ a subjekte biznesi, nga të cilat do të paguhen pensionet e tyre apo të punëtorëve të tyre.

Entitetet të cilat krijojnë plane pensionale – që shumë shpesh quhen sponzorë të planit janë:

- a) Entitete nga biznesi privat, që veprojnë për punonjësit e tyre.
- b) Entitete shtetërore (nivel qendror dhe lokal), që veprojnë në emër të punonjësve të tyre.
- c) Unione, në emër të anëtarëve të tyre, dhe individë që japin kontributë për beneficione pensionale.

Fondet pensionale, në shumicën e vendeve në treg të zhvilluar, zënë vend titullari, si lojtarë ndër më të fuqishmit në tregjet financiare, sepse fondet pensionale disponojnë me kapital shumë të madhë.

Fondet pensionale financohen nga kontributet e punëdhënësve dhe të punëtorëve, në disa plane të fondeve, në disa variabla, kontributet e punëdhënësve janë të barabarta me kontributet e punëtorëve.<sup>66</sup>

---

<sup>66</sup> Dr. Safet Merovci: "Tregjet dhe instrumentet financiare", Prishtinë, 2004, faqe 271.

## KONKLUZIONET

Gjatë punimit kam hasur në probleme dhe sfida të ndryshme për të arritur qëllimin tim, që ky punim të ketë rezultatë, prandaj me angazhimin dhe punën e pa lodhëshme ku nuk ka munguar as vullneti gjatë hulumtimeve, kërkimeve dhe komunikimeve me shumë ekonomist dhe njohës të mirë të kësaj lamiye dhe shumë përpjekjeve tjera kam arritur në mënyrë sa më të qartë ta shpjegoj titullin e këtij punimi dhe duke marr shembuj e duke komentuar pothuajse çdo institucion finaciar dhe ndikimin që ato kanë në ekonomi .

Duke marr parasysh rolin dhe funksionet e institucioneve financiare ato kanë një ndikim shumë të madh në ekonomin e një vendi të pa zhvilluar apo në zhvillim e sipër, duke filluar nga Banka Botërore për zhvillim, që japin kredi, me kamatën e kredis që fitojnë paguajnë tatim shtetit, ku shtetit i shtohen të ardhurat, për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomis e deri tek mikro bankat që japin mikro kerdi, për mikro bizneset apo bizneset e vogla, arrin që ta rrisin ekonomin e një vendi, me hapjen e bizneseve të reja, hapen vende pune e shumë të mira tjera ku formojnë edhe imazhin e themelimit, forcimit dhe zhvillimin e një ekonomie.

Duke parë rolin dhe ndikimin e institucioneve financiare që kanë, kam ardhur në përfundim se këto institucione duhet menaxhuar dhe kontrolluar jashtëzakonisht mirë që të kthehen borxhet të përcillen kamata e bankave në interes të shtetit dhe shumë detaje tjera që të shkojmë në hapa të sigurt sepse institucionet finaciare të japin mundësin për zhvillim, por në qoftë se këto institucione nuk menaxhohen, nuk kontrollohen, nuk projektohen ashtu si duhet arrin që një shtet të ketë nje ekonomi të ulët në zhvillim. Prandaj kemi shembuj të shumtë në shumë shtete dhe biznese që janë zhvilluar shumë nga ndihma e institucioneve finaciare, por kemi edhe nga ato biznese që kanë bankrotuar apo falimentuar .

Shembull konkret të kohës së fundit mund ta marrim Greqin e cila është në prag të bankrotimit të shtetit për shkaqe të borxheve të mëdha që ka ndaj bankave, dhe shembull tjetër mund ta marrim Kosovën e cila me mos menaxhim dhe mos projektim dhe respektimin e rregullave të institucioneve më të larta botërore ka humbur disa kredi të rëndësishme nga shumë Banka Botërore, me kamata të larta të bankave në vedin tonë, e

shumë parregullsive tjera në institucionet financiare tona ku po ngecin shumë në zhvillimin e vendit tonë, prandja duhet intervenuar shumë shpejt, sepse në një të ardhme të shkurtër vendi ynë mund të hyjë në një kaos të rrezikshëm financiar .

## PËRFUNDIMI

Gjatë punimit në këtë temë kemi bërë kërkime, hulumtime, studime dhe kemi arritur të kuptojmë dhe të sqarojmë: Çka janë Institucionet Financiare? Çfarë ndikimi kanë ato në një shtet apo shoqëri ?

Institucionet financiare janë ato organizata, që përfshihen në dhënien e llojeve të ndryshme të shërbimeve financiare të klientëve të tyre. Institucionet financiare janë të kontrolluara dhe të mbikqyrura nga rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga autoritetet qeveritare.

Funksioni kryesorë të institucionet financiare është mbledhja e fondeve nga investitorët të drejtëpërdrejtë të fondeve për ofruesit e shërbimeve të ndryshme financiare.

Në funksionet e institucioneve financiare bëjnë pjesë bankat, unionet e kreditit, firmat e menaxhimit të aseteve, ndërtimin e shoqërive dhe ndërmjetësit e aksioneve po ashtu qëndrojnë edhe bursat, tregjet e mallrave, monedhat dhe mundësit e shkëmbimeve ku janë shumë të rëndësishme për ekonomin. Këto institucione janë të përfshira në krijimin dhe sigurimin e pronësisë për pretendime financiare, gjithashtu janë edhe përgjegjëse për ruajtjen e likuiditetit në treg dhe menaxhimin e rreziqeve të ndryshimit të çmimeve. Si pjesë e shërbimeve të tyre sigurojnë mundësitë e investimeve për ti ndihmuar bizneseve për gjenerimin e fondeve për qëllime të ndryshme.

Vlerësimi i institucioneve financiare ka të bëjë me vlerësimin e fletëve të bilancit dhe shumë aspektëve të institucioneve financiare. Procesi i vlerësimit të institucioneve financiare është i njohur si vlerësim i korporatave ose si vlerësim i institucioneve financiare.

Dallojmë institucione financiare depozituese që përfshijnë bankat komerciale ose thënë shkurt bankat, asociacionet e kursimeve dhe të huave, bankat e kursimeve dhe unionet e kreditit, ku janë ndërmjetës financiar të cilët pranojnë depozita – pranuese. Me fondet e shtuara përmes depozitave dhe fondet tjera nga burime të ndryshme, institucionet depozituese po ashtu u japin hua direkte entiteteve të ndryshme dhe investojnë në letra me vlerë.

Kemi edhe institucione financiare jo depozituese ku karakteristikat kryesore institucioneve financiare jodepozituese është se deri te mjetet e tyre që u mundësojnë kryerjen e aktiviteteve biznesore, nuk vinë përmes mbledhjes së depozitave nga publiku dhe institucionet tjera financiare dhe jofinanciare për këtë e bëjnë nga komisionet dhe nga investimet e tyre. Dallojmë dy grupe të institucioneve financiare jodepozituese: Institucionet kontraktuese, Institucionet investuese.

Institucionet financiare Bankare janë një nga institucionet më të rëndësishme në një ekonomi, pasi që ato janë burim kryesor i kredive për individët, familjet, si dhe institucionet ndërmarrjet e ndryshme .

Banka Qendrore është banka kryesore në sistemin financiar të një vendi e cila i rregullon marrëdhëniet monetare dhe kreditore të një vendi. Banka Qendrore si institucion financiar i sistemit monetar është e detyruar që të kujdeset për vlerën e njësisë monetare të vendit, për rregullimin e qarkullimit të parave dhe të likuiditetit të sistemit bankar si edhe për likuiditetin në vend dhe atë ndërkombëtar. Karakteristikë e veçantë e bankave qendrore është se qëllimi i veprimtarisë së tyre nuk është fitimi, gjë që dallohet prej bankave dhe institucioneve të tjera.

Institucionet financiare jobankare, janë shoqëri të cilat kryejnë aktivitete të ndërmjetësimit financiar dhe aktivitete të tjera ndihmëse, të lidhuar ngushtë me ndërmjetësimin financiar por që nuk klasifikohen si pranues depozitash. Disa nga këto aktivitete përfshijnë: lansing, investimi në letra me vlerë etj. Ekzistojnë pesë grupe kryesore të këtyre institucioneve financiare: Organizatat financiare depozituese, Institucionet për kursimin e kontraktuar, Organizatat financiare investive, Kompanit financiare, Organizatat financiare të përziera.

Institucionet qendrore të qarkullimit të pagesave veprojnë si shtëpi kliringe të bankave të kursimeve, që i sigurojnë me të gjitha shërbimet e qarkullimit të pagesave, i ruajnë rezervat likuide të bankave të kursimeve, kryejnë shërbime si: pagesa me jashtë (për të cilat bankat e kursimeve nuk kanë leje), bëjnë operacione me letra me vlerë, sigurojnë ndikime teknike dhe këshilla në menaxhmentin investiv, kryejnë lizingun, faktoringun dhe përpunimin e të dhënave.



Organizatave financiare ndërkombëtare u formuan pas krizes së madhe të vitit 1929 të cilat do të ndikonin në tejkalimin e çregullirave financiare dhe ripërtrirjen e ekonomisë nga lufta, ato ishin Fondi Monetar Ndërkombëtar (International Monetary Fund – IMF) dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (International Bank of Reconstruction and Development – IBRD). Më pas u formua institucione të përcaktuara të cilat do të financojnë zhvillimin e ndërmarrjeve private në vendet anëtare të Bankës Botërore dhe zhvillimin ekonomik të vendeve më pak të zhvilluar ato janë Korporata Financiare Ndërkombëtare (International Financial Corporation – IFC) dhe Shoqata Ndërkombëtare për zhvillim (International Development Association – IDA). Organizatat financiare regjionale.

Karakteristikë e orgatizatave financiare regjionale është se ato kryejnë aktivitetin e tyre në një vend të caktuar, por për një grup të shteteve të cilat në pikpamje ekonomike ose praktike janë të lidhura me interes reciprok. Në grupin e orgatizatave financiare regjionale hyjnë: Banka për Likuidimin e Llogarive Ndërkombëtare, Banka Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ekonomik, Unioni Evropian i Pagesave, Banka Investive Evropiane, Banka Ndërkombëtare Investive, Banka Interamerikane për Zhvillim, Banka Afrikane për Zhvillim, Banka Islamike për Zhvillim, Banka Arabe për Zhvillim Ekonomik dhe Banka Aziatike për Zhvillim.

Përmbajtja e sigurimeve institucionale, nga aspekti shkencor kuptimi i sigurimit si kategori ekonomike e prodhimeve të mallrave, është mënyra e posaçme e sigurimit të mjeteve monetare (fondi monetar), përmes bashkimit të mjeteve. Në këtë mënyrë krijohen mjete me qëllim që të shpërndahen dëmet nëpër shumë subjekte tek të cilat ekziston rreziku nga dëmet.

## REFERENCAT/LITERATURA

- Prof. Dr. Gazmend Luboteni: “Bankat dhe afarizmi bankar”, Prishtinë, 2006.
- Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: “Financat”, Prishtinë, 1986.
- Prof. Dr. Sabahudin Kumoni: “Financat”, Prishtinë, 2008.
- Dr. Safet Merovci: “Tregjet dhe instrumentet financiare”, Prishtinë, 2004.
- Dr. Sc. Xhevat Bakraçi: “Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimi”, Prishtinë, 2004.
- <http://financat.mapsofworld.com/financat-institutions/>
- [http://en.wikipedia.org/wiki/financial\\_institution](http://en.wikipedia.org/wiki/financial_institution).
- <http://www.bqk-kos.org/>
- [Provimet.weebly.com/Organizata\\_Financiare\\_Nderkombetare](http://Provimet.weebly.com/Organizata_Financiare_Nderkombetare).
- [Open.data.al](http://Open.data.al).
- [sq.wikipedia.org/wiki/Fondi\\_Monetar\\_Nderkombetar](http://sq.wikipedia.org/wiki/Fondi_Monetar_Nderkombetar).
- [www.eib.org/about/structure/index.htm](http://www.eib.org/about/structure/index.htm).
- [www.bicusa.org/en/institution.2.aspx?](http://www.bicusa.org/en/institution.2.aspx?)
- International Monetary Fund Annual Report – 2005
- Annual Report, world Bank – 2005.